



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 16/1 datë 30/01/1998

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur sot me dt.30.01.1998, analizoi kërkesën e Z.Mehmet Loci me Nr.M-112 Prot., dt.02.02.1998 e cila është arshivuar pranë Këshillit Bashkiak. Me propozimin e grupit të Këshilltarëve të përbërë nga Z.Orhan Sakiqi, Z.Përparim Bodinaku, Z.Luan Shaollari, Znj.Liri Deliu, Z.Musa Ulqini etj, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të pajiset me status të pastrehë Z.Mehmet Loci.
2. Duke qënë se banesa që duhet të dorëzonte pranë Entit Kombëtar të Banesave i është marrë padrejtësisht nga pushteti lokal, atëherë të pajiset me një autorizim sipas VKM Nr.530, dt.17.10.1994, “Për mënyrën e ndarjes së apartmenteve nga Enti Kombëtar i Banesave”, ku të cilësohet se nuk dorëzon banesë.
3. Për veprimet e mësipërme të padrejta nga ana administrative, i kërkohet Entit Kombëtar të Banesave që në zbatim të ligjit Nr.8030, dt.15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, pjesën që i takon falas t’i zbritet nga vlera e banesës që merr nga ky institucion, duke mos respektuar prioritetet e këtij ligji.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI